



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 16-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28. 02. 2019, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Lulzim Rrustemi, anëtar
12. Ramiz Qeriqi, anëtar
13. Argjent Tasholli, anëtar
14. Nazmi Krasniqi, anëtar
15. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
16. Egzona Bytyqi, anëtare
17. Selatin Retkoceri, anëtar
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Afrim Miftari, anëtar
21. Hajdin Bytyqi, anëtar
22. Safete Amerllahu, anëtare
23. Bashkim Budakova, anëtar
24. Ukë Kryeziu, anëtar
25. Ganimete Qeriqi, anëtare
26. Manush Shamolli, anëtar
27. Egzona Fazliu, anëtare
28. Arben Salihu, anëtar
29. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës për komunitete
4. Diamant Bytyqi, zëdhënës i Komunës

5. Rasim Hasani, drejtor i DA
6. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
7. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
8. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
9. Bekim Shabani, drejtor i DRSK
10. Sefer Tasholli, drejtor i DGJK
11. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
12. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
13. Vlora Limani-Hajnuni, drejtoreshë e DSHMS
14. Vlora Krasniqi, zyrtare ligjore
15. Kimete Jashanica, OSBE-së
16. Bukuriye Zejnullahu, zyra e informimit
17. Besart Troshupa, zyra e informimit
18. Bestar Ibrahim, i,
19. Haki Avdiu,
20. Bekim Krasniqi, OJQ "YAHR"
21. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 29 anëtarë nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës së propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 15-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale KBI në Lipjan për ndërtimin e Xhamisë në f.sh. Grackë e Vogël
3. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubovc
4. Propozim Vendim për caktimin e lartësisë së qirasë joprofitabile për banesat komunale në kuadër të ndërtesave me koncesion „DINO” dhe „EUROKOS” në Lipjan
5. Propozim Vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshëmrive
6. Raporti i buxhetit dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve kategorive ekonomike dhe programeve për vitin 2018 për Komunën e Lipjanit.
7. Propozim Vendim mbi dhënien e pelqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2017 dhe 2018 në vitin 2019
8. Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2018
9. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer
10. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës
11. Propozim Vendim për aprovimin e projekteve kapitale
12. Raport i punës zyrës së Kryetarit dhe drejtorateve komunal për vitin 2018

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit pyeti se a ka dikush vërejtje rreth rendit të ditës.

Meqë nuk pati vërejtje as plotësime me të gjitha votat prezente kaloi rendi i ditës.

Pastaj Kryesuesi, Daut Azemi, tha se vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit .

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi. Kam një pyetje për drejtorin e DSHP, Ilir Tashollin, rruga që fillon te Stadiumi „Sami Kelmendi” deri te udhëkryqi Rubovc dhe Glllogovc se a është duke u punu dhe nga cili grant?

Egzona Fazlija, kam një pyetje për drejtorin e DSHP, për kanalizimin në Bregun e Zi a është duke u punuar dhe deri ku ka mbërritur.

Ukë Kryeziu, deshta ta ngris një shqetësim dhe kam një kërkesë për drejtorin e DSHP të kërkoj nga ujsjellësi. Në fshatin Sllovi ka pëlcit një gyp i ujit dhe 50% e fshatit ka mbet pa ujë që 5 ditë, andaj kërkojmë që të sanohet sa më shpejt ky problem.

Bashkim Budakova, kam me ngritë një çështje për drunjët dekorues kërkoj nga organi përgjegjës që t'i kushtohet një kujdes të gjithë atyre drunjëve dekorues në rrugën "Hamëz Jashari" dhe te Qerdhja.

Shkelzen Bislimi, po e ngris një shqetësim të lagjes Agushi janë diku 10 familje e që nuk janë të kyqur në rrjetin e kanalizimit. Kisha kërku që atyre banorëve t'u bëhet një zgjidhje se gjatë sezonës së verës është shumë problem. Po ashtu kam një pyetje për drejtorin e arsimit a ipen bursa për studentët e dalluar dhe sa është vlera. Nëse jo atëherë kërkoj arsyjen pse nuk ndahen.

Ramiz Qeriqi, unë i kam dy raste, rasti i kanalizimit në Krojmir, në seancën e kaluar unë nuk e kam kuptuar kërkuuesin dhe as përgjigjjen e Kryetarit. Kompania që ka pasur ta kryej punën te nënkalimi a ka pas me kry edhe punën aty ku po rrjedh uji në mes të asfaltit. Lumi është bërë mirë që është pastru por ka nevojë për tri ura. Kisha kërku që të ndërtohen me buxhet të Komunës në Krojmir pa participim. Po më intereson puna e OJQ "YAHR" dhe OJQ "POLIS" pse nuk po interesohen për shqetësimet e qytetarëve. Po ashtu po më intereson puna e dy drejtorëve çfar pozite kanë njëri në KKSB dhe njëri në auditim dhe sa marrin meditje.

Nazmi Krasniqi, unë i kam dy shqetësime riemërimit e rrugëve deri ku ka shku dhe në fshatin Smallushë hapja e lumit kur është bërë është dëmtuar rrjeti i kanalizimit dhe ende nuk është renovuar.

Lumturije Bytyqi-Hasani, në kohën e fundit shihet se ka ra numri i lindjeve në Lipjan për shkak të kushteve. Propozoj që në mbledhjet e ardhshme të vjen një propozim vendim në Kuvend për subvencionimin e grave që lindin në Komunën e Lipjanit. Këtë po e them pasi që disa komuna këtë e kanë bërë praktikë siç është komuna e Hanit të Elezit e një komunë tjetër.

Ilir Tasholli, sa i përket rrugës rreth hekurudhës ka filluar në vitin e kaluar, ndërsa punimet janë ndërpre për shkak të kërkesës nga hekurudha. Kanalizimi në Breg të Zi ka probleme por është një projekt 2 vjeçar ka filluar në vitin e kaluar dhe do të përfundoj në këtë vit. Ndërsa 6 metra të kanalizimit i bjen të kalojnë në territorin e komunës së Shtimes. Ndërsa sa i përket ujësjellësit në Sllovi nuk kemi qenë të njoftuar për këtë çështje por do të komunikojmë me drejtorin dhe do të mundohemi që ta zgjidhim problemin. Drunjët dekorativ kanë ndodh veprime jo të mira ku disa individ i kanë dëmtu ata drunjë por ne me fillimin e sezonës do t'i zëvendësojmë ata drunjë të cilët janë dëmtuar. Në lagjen e Agushëve në Gadime kam qenë unë vetë në atë lagje dhe as unë nuk e di pse është mbetur ajo lagje pa kanalizim por do të mundohemi të bëjmë një zgjidhje për atë pjesë. Ndërsa kanalizimi në Krojmir është projekt 2 vjeçar dhe ende nuk ka përfundua, po ashtu te lumi do të ketë ma shumë se 2 ura për banorët e asaj lagje të Krojmiri. Në Smallushë po presim të rregullohet koha dhe të fillojmë në punë rreth defekteve në kanalizim.

Rasim Hasani, sa i përket bursave Kuvendi nuk ka miratu buxhet dhe nuk do të ketë bursa prandaj në këtë vit nuk do të ketë bursa për shkak të mundësive buxhetore.

Vlora Limani-Hajnuni, unë kam kërkuar në vitin e kaluar që përveç rasteve të rënda të maternitetit të mos ndalen në Lipjan për shkak të kushteve teknike, ambientale që nuk i plotëson ky sektor. Këtu në Kuvend është votu një projekt që ka për qëllim renovimin e maternitetit në këtë vit dhe presim që do të rriten lindjet.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, sa i përket participimit kanë kaluar koha e participimit dhe nuk ka më nevojë më që të participojnë qytetarët.

Ramiz Qeriqi, unë në bisedë me Kryetarin e fshatit më ka thënë që Komuna na ka thënë që ju duhet me participu, ndihmu nga pak. Unë kërkoj një sqarim nga drejtori Kompania që e ka marrë rregullimin e lumit a e ka për obligim me e kry edhe te lagja e Qeriqëve nalt te nënkalimi? Pasi që po dalin ujërat e zeza në asfalt dhe a e ka pasur për detyrë me e rregullu ate apo jo?

Ilir Tasholli, kompania punën do të kryej të tërën, ndërsa në projekt janë 3 ura dhe nuk do të ketë nevojë për participim të qytetarëve. Në Krojmir i kemi 2 kompani të kontraktuara.

Ramiz Qeriqi, si quhet kompania që e ka bërë rregullimin te nënkalimi.

Ilir Tasholli, në seancën e ardhshme do të merrni përgjigjet.

Hyra Bytyqi, kam një pyetje për drejtorin e administratës deri ku ka arrit procedura për ID e anëtarëve të Kuvendit Komunal.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 15-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Ramiz Qeriqi, kam vërejtje te diskutimi i Kryetarit kur ka debatuar me anëtarin tonë Argjendin fjalët nuk janë shenu.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, ju kisha lutë që kur të folni folni me mikrofon e jo t'u repliku herë njëri herë tjetri pasi që të gjitha nuk po mundet me i shenu.

Lumturije Bytyqi-Hasani, edhe unë pajtohem me Ramizin që të kenë kujdes si po shënohet nga ana e proqesëmbajtësit.

Meqë vërejtje të tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 15-te dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 votat për, një apstenim

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 15-të e Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale KBI në Lipjan për ndërtimin e Xhamisë në f.sh. Grackë e Vogël

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Bekim Shabanit, drejtor i DKRS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arben Salihu, po flas në emër tim personal, është fatëkeqësi që 20 vite nga paslufta imamët dhe priftërinjtë mbeten ende barrë e popullit. Ndërsa shteti ynë ka dështu duke mos bërë një Ligj për Bashkësitë fetare. Bashkësia Islame dhe Kryetari i sajë janë në pozitë të vështirë kur është në pyetje ndarja e vendeve për Xhami. E falënderoj Kryetarin e Komunës dhe zyrtarët e Bashkësisë Islame që po kontribojnë por do të ishte mirë që të na kuptojnë edhe qytetarët që të jenë më racional dhe më të arsyeshëm kur t'i drejtojnë kërkesat e tyre. Kisha kërku që mos na keqëkuptojnë qytetarët por do të ishte mirë që të ketë disa kriteret se ku duhet të ketë objekte fetare. Sa do e mirë që do të jetë një Xhami për qytetarët në atë Xhami duhet të ketë edhe një Imam, edhe obligime tjera. Ne e mbështesim këtë propozim vendim por shpresojmë që në të ardhmen të ketë një Rregullore për kriteret e ndërtimit të objekteve vetare.

Nehat Tërpeza, ne si grup e kemi shqyrtu dhe e mbështesim, pasi që ka edhe një pajtim në mes të qytetarëve dhe shpresojmë që të implementohet siç është paraparë.

Fauz Xhemajli, Nënkryetar i Komunës, unë kam një kërkesë prej Bashkësisë Islame, nuk e dijë a e përkrahin apo jo që pikëpamja arkitekturore le të jetë shqipëtare.

Afrim Miftari, është mirë që kërkesat kur t'i bëjnë qoftë qytetarët qoftë Bashkësia Islame të shënojnë arsye pak më të mëdha ku të përshkruhen kriteret se a ka nevojë apo për atë Xhami, nënshkrimet e banorëve etj. Ne si grup e përkrahim këtë propozim vendim.

Selatin Retkoceri, e falenderoj Arbenin për përshkrimin që e bëri skam çka i shtoj asaj që e tha Arbeni. Këtu duhet që edhe Bashkësia Islame të shoh se ku është e nevojshme të ndërtohet e jo të ndërtohet nëpër fshatra të vogëla siqë është Qallapeku e Gracka, pasi që problemi po është zingjiror dhe po shkakton probleme siqë janë: pagesa e Imamit, mirëmbajtja etj. Është mirë që të shikohet se sa është e nevojshme të investojmë e jo të investohet atje ku nuk ka banorë pasi që numri i popullatës nuk është në rritje por po zvogëlohet. Unë jam i interesuar që të cakohet numri i hoxhollarëve sikurse që caktohet për arsimtarët dhe unë jam që të jetë edhe një Ligj për hoxhollarët.

Fauz Xhemajli, ka Xhami me arkitekturë shqipëtare, në Lipjan ka Xhami e cila nuk dihet se a është Tyrbe apo Xhami.

Arben Salihu, Nënkryetari e ka qëllimin me thënë infrastrukturë të Xhamive të cilat është mësu syni i jonë me i pa siqë janë këto Xhamiat e mëherëshme e jo si që është rasti i asaj Xhamisë në Hallaq.

Nazmi Kraçiqi, kam pyetje për drejtorin rreth financave a do ta ndihmoj komuna këtë rast a ka ndonjë informacion.

Ramiz Qeriqi, e falenderoj Arbenin për sçarimin që e dha po ashtu e falenderoj edhe Nënkryetarin i cili me sa e kuptova unë tha të ketë ndonjë simbl shqipëtar. Do të ishte e mirë pasi që do të rritej numri po ta kishte Shqiponjën apo ndonjë simbol shqipëtar, do të shkoja edhe unë që të lutesha aty. Edhe te Kisha ortodokëse serbët e kanë vendos flamurin edhe pse qendrën e kanë në Beograd.

Nehat Tërpeza, kam një kërkesë nga Bashkësia Islame që herave tjera kërkesat e tyre të jenë pak më serioze t'i bashkangjitet edhe projekti. Më herët kemi dhënë pronë edhe për ndërtimin e Xhamisë në Lipjan por nuk e dijmë se qfarë projekti ka ajo Xhami dhe për sa banorë do të ndërtohet.

Arben Salihu, ka Xhami në Lipjan e cila Shqiponjen e ka të vendosur në vend të Hënës e ajo gjindet në fshatin Gumnasellë.

Lulzim Rrustemi, me qenë se ka një koncenzus të banorëve të fshatit Grackë ne si grup e përkrahim.

Bekim Shabani, Xhamija nuk financohet nga Komuna por vetëm pronën ja ndanë Komuna.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Vendim dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 25 votat për, 1 apstenim aprovoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË FSHATIN GRACKË E VOGËL

Neni 1

Me këtë vendim ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh prona komunale me sipërfaqe prej 1000m² (10 ari) Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për ndërtimin e xhamisë për nevojat e banorëve në fshatin Grackë e Vogël, nga parcela kadastrale P-71409051-00106-1 në vendin e quajtur "Kod Groblja" me kulturë kullosë e klasit 2-të zona kadastrale Grackë e Vogël, Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 2

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit të parcelës 00106-1 me sipërfaqe prej 1000m² KK Lipjan shfrytëzues Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

III

Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubovc

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Bekim Shabanit, drejtor i DKRS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ramiq Qeriqi, unë jam për dhënien e kësaj prone, por kisha kërku që Komuna të bëjë edhe rrethojen.

Bashkim Budakova, ka qenë kërkesë e kahëmotshme e banorëve të asaj rrethine pasi që edhe vetë vijë nga ai lokalitet, pasi që prona e mëherëshme nuk ka qenë e mjaftueshme. I falenderoj të gjithë akterët po ashtu kërkoj nga të gjithë mbështetjen për këtë propozim vendim.

Nehat Tërpeza, ne si grup e mbështesim këtë propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për varrezat e fshatit Rubovc.

Ukë Kryeziu, unë kam një çështje tjetër nuk jam kundër por kisha kërku që prona mos t'i ipet Bashkësisë Islame por t'i mbetet Komunës,se momintin që ja japim Bashkësisë Islame nuk e dijë se sa do të mund të menaxhojna me to.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Vendim dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR VARREZA NË FSHATIN RUBOFC

Neni 1

Me këtë vendim, ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh pronat komunale, Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, si në vijim:

1.Parcela kadastrale P-71409068-00756-0 në vendin e quajtur "Drum çeramdnica" me kulturë arë e kl.3-të me sipërfaqe prej 3517m² Zona kadastrale Rubofc, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

2. Parcela kadastrale P-71409068-00757-0 në vendin e quajtur "Drum" me kulturë jo Pjellore me sipërfaqe prej 4976 m² Zona kadastrale Rubofc, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 2

Pronat komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi ipen në shfrytëzim me destinim për varreza në fshatin Rubofc dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime tjera.

Neni 3

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit, KK Lipjan shfrytëzues Këshilli i

Bashkësisë Islame në Lipjan me destinim për varreza, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Shërbime Publike.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim Vendim për caktimin e lartësisë së qirasë joprofitabile për banesat komunale në kuadër të ndërtesave me koncesion “DINO” dhe “EUROKOS” në Lipjan

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën i dha fjalën Vlora Limani-Hajnuni, drejtoreshë e DSHMS, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Selatin Retkoceri, te përcaktimi i qirasë te vlera blerëse kostoja e banimit me koeficient 0.04 për 12 muaj kam dështirë me ditë se si caktohet kostoja dhe a është e caktuar kostoja.

Afrim Miftari, mendoj që është një vlerë reale por kisha apelu te përfituesit e banesave që t'i mirëmbajnë këto banesa. Në emër të grupit të AKR-se e përkrahim këtë propozim vendim.

Anila Reçica, ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim. Duke e dijtë se komuna ka për qëllim t'ju lehtësoj barrën e qirasë për 21 familje duke i llogaritur 50% të qiraqisë.

Ramiz Qeriqi, shpresoj që pagesa e qirasë të jetë sa më e ulët kam një pyetje ankesat të cilët i kanë bërë ata që nuk kanë përfituar a ju keni përgjigj. Kam edhe një pyetje kur jeni ardh ju në pushtet kryetari i juaj ka pas thënë që janë humbë 100m² të banesave, dyshojke ky kryetari se ai kryetari tjetër i ka marrë deshta ta dijtë se a ka hulumtu ky kryetari a i ka gjetë apo ndoshta i kanë nda bashkë me kryetarin e kaluar? Pres me na njoftu në mbledhjet e ardhshme rreth kësaj çështje.

Lulzim Rrustemi, mua po më duket se çmimi shumë i shtrejtë pasi që 50€ është një shumë kogja e madhe dhe është e vështirë të përballohet nga këto familje pasi që janë raste sociale. Nuk e dijtë se a ka mundësi komuna me pagu pak më shumë pasi kam frikë që nuk do të mund ta arrijnë ta paguajnë qiran.

Selatin Retkoceri, me qenë se këtu nuk po thotë vlera e banesës por vlera e ndërtimit nuk është për qëllim çmimi sa shitet por sa ndërtohet. Në Lipjan mund të jetë edhe 150€ vlera e ndërtimit e kjo e ulë kogja mirë çmimin e qirasë.

Vlora Limani-Hajnuni, ky propozim është i bazuar sipas ligjeve në fuqi dhe kjo formulë është në bazë të Ligjit ku për një banesë 125m² i bjen 25 deri 30€ qira në muaj. Kjo vlerë e qirasë ka për qëllim renovimin dhe mirëmbajtjen e objekteve.

Afrim Miftari, te neni 2 është e pa kuptueshme vlera totale e banimit unë kisha propozu që të hiqet vlera totale e ndërtimit.

Lulzim Rrustemi, vlera e ndërtimit është 270€ dhe qiraja prej 30-35€ prap po më duket çmim i lartë.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendim dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 23 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË QIRASË JOPROFITABILE PËR BANESAT
KOMUNALE NË KUADËR TË NDËRTESAVE ME KONCESION “DINO” DHE
“EUROKOS” NË LIPJAN

Neni 1

Me këtë Vendim caktohet lartësia e qirasë joprofitabile për banesat komunale të dhëna me qira sipas legjislacionit në fuqi, të cilat gjenden në kuadër të objekteve me koncesion “DINO”, rruga ”Lidhja e Prizrenit dhe “EUROKOS”, rruga “Isa Olluri” në Lipjan.

Neni 2

Bazuar në nenin 9 par.1 të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, përcaktimi i vlerës së qirasë bëhet sipas formulës:

$$Qjm = \frac{Vb \times 0.04}{12} \quad \text{ku:}$$

Qjm-Qiraja joprofitabile mujore

Vb-Vlera e ndërtimit të banesave e cila llogaritet sipas sipërfaqes së shfrytëzueshme të banesës dhe vlerës totale të ndërtimit.

Neni 3

Shuma e qirasë e cekur në nenin 2 të këtij Vendimi do të shfrytëzohet për mbulimin e kostos së administrimit, mirëmbajtjes, amortizimit, riparimet e rregullta dhe investuese të pjesës komunale të objektit të banimit.

Neni 4

Pjesa prej 50 % e shumës së qirasë joprofitabile siq përcaktohet në nenin 2, subvencionohet nga buxheti i Komunës bazuar në nenin 10 par.1 të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim Vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerive

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Sefer Tasholli, drejtor i DGJK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendim.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Selatin Retkoceri, po më duket një projekt shumë i rëndësishëm dhe me vend për ta bërë sa më të jetueshëm atë vend. A do të lidhet me rrugën tranzit.

Majlinda Sylejmani, ne si grup e kemi shqyrtu këtë propozim vendim dhe e përkrahim pasi që kjo rrugë po bëhet edhe me ndriçim publik dhe ajo lagje te Konjuhi çdo ditë e më shumë po rritet. Me shpronësimin e këtyre pronave do të ketë qarkullim më të lirë të qytetarëve.

Afrim Miftari, ne e kemi shqyrtu këtë propozim vendim kjo është në të mirë të qytetarëve dhe e përkrahim këtë .

Lulzim Rustemi, kam një pyetje po më intereson fleta poseduese rruga e vjetër sa është e gjërë dhe a është e hapur deri te hekurudha dhe cilat janë konditat e rrugës me fletë poseduese dhe ne si grup e përkrahim.

Sefer Tasholli, hapsira e rrugës është 7m, ndërsa qe 4 vite është e bllokuar nga një familje Vitija dhe ne për shkak që skemi dokumentacion të bollshëm kadastral. Për ndryshe kjo do të jetë në interes të qytetarëve.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendim dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 23 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM PËR SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK PËR SHPRONËSIM TË PALUAJTSHMERIVE

Neni 1

Miratohet Vendimi për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerive të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga projekti për ndërtimin e rrugës me trotuar, ndriçimi publik në lagjen e Konjuhit rreth shtratit të lumit “Janjevka” në Lipjan, sipas listes së pronave të përshkruara nga evidenca kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik, si dhe sipërfaqet e tyre të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 2

Vlera e kompensimit të pronës caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativë nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

Neni 3

Obligohet Zyra e Kryetarit-sektori pronëso- juridik pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të zhvilloj procedurat e shpronësimit në pajtim me dispozitat të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Urbanizëm Planifikim, Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastrë dhe Drejtorati i Shërbimeve Publike.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtes:Vendimi.

VI

Raporti i buxhetit dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve kategorive ekonomike dhe programeve për vitin 2018 për Komunën e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i buxhetit dhe shpenzimeve.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Selatin Retkoceri, unë do të ndalem në disa pozicione ku koeficienti i shpenzimeve 92.09 është solid i mirë. Financimi nga huamarrjet jo e mirë. Të hyrat vetanake është një vërejtje se nuk po shfrytëzohen ashtu siç duhet. Buxheti i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, mallra dhe shërbime është dashtë të jetë më e mirë. Subvencione dhe transfere edhe këto duhet me qenë më mirë. Grantet qeveritare mirë. Nga donatorët keq. Zyra e kryetarit është mirë, administrata dhe personeli mirë. Shërbimet Publike ka punë me punu, ndërsa me na tepu mjetet jo mirë. Kujdesi primar shëndetësor mirë, bujqësia jo mirë, po ashtu Kulturë, Rini dhe Sport jo mirë. Ekzekutimi nga thesari pse kaq shumë mjete. Mëditjet për udhetime zyrtare është pak janë ku kemi probleme me zhvillim ekonomik. Posta dhe telekomit shpenzime koxha të larta. Mirëmbajtja dhe riparimi i veturave 20 mijë euro, ndërsa me qira veturat që i keni marrë vetëm 13 mijë euro kështu që më mirë merrni vetura me qira bile nuk hargjoni për mirëmbajtje.

Lulzim Rrustemi, shpenzimi i buxhetit me shiku del se është mirë, ndërsa nëse hyjmë në detaje e shohim se paraja publike shumë dobët është regjistru. Buxheti i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike shifer e vogël. Subvencione dhe transfere shumë e vogël. Te investimet kapitale shifer hala më e vogël. Buxhetin nga të hyrat vetanake kanë tepu mjete pse nuk janë shfrytëzu ato. Te Shërbimet Publike te granti qeveritarë nuk janë shpenzuar mjetet dhe kemi një menaxhim të dobët të buxhetit. Te bujqësia nuk janë shfrytëzu 43 mijë euro e kur dihet që kanë nevoja të mëdha qytetarët. Te planifikimi urban kemi një përqindje të votël të shpenzimeve. Po ashtu shpenzim të vogël të mjeteve kemi në shëndetësi, Kulturë, Rini dhe Sport. Te investimet kapitale dhe investimet kapitale të bartura kemi 47 mijë euro të pa shfrytëzuara, te arsimi 64 mijë euro të pa shfrytëzuara ku në përgjithësi arsimi nuk është menagjuar mirë. Te shpenzimet sipas kategorive ekonomike për mirëmbajtje të veturave kemi mbi 30 mijë euro, telefonja mobile një shifer alarmante që duhet me u shqetësu, po ashtu edhe shpenzime për karburante edhe këtu është një shifër shqetësuese. Buxheti nuk e ka shfrytëzimin më të mirë dhe unë mendoj që ky buxhet ka ngecje.

Hyra Bytyçi, po e diskutojmë një raport mjaft të rëndësishëm, raport i cili i ka edhe sfidat e veta. Në përgjithësi kemi shpenzim të mirë të buxhetit mbi 92%. Çdo shpenzim i buxhetit i realizuar mbi 75% konsiderohet shpenzim i mirë i buxhetit. Vështirësi ka qenë për shkak të rishiqimit të buxhetit që nuk është leju dhe ridestinimit të vonshëm të buxhetit. Të hyrat vetanake i kemi mbi 5%, ndërsa të hyrat e tatimit në pronë mbi 20%. Këto mjete edhe pse po barten prej vitit në vit po bëhen për të mirën e qytetarëve. Vështërsi e këtij buxheti ka qenë edhe thesari i cili me krahasu me vitin e kaluar këtë vit ka ekzekutu mjete mbi 50%. I përgëzoj ekzekutivin që kanë bërë një menaxhim të mirë financiar.

Albulena Kelmendi, ajo që mundem me konstatu se është shpenzu një buxhet i kënaqshëm mbi 92%, ndërsa nëse e shiqojmë në brendësi secilën veç e veç nuk është i kënaqshëm dhe është i dobët. Komuna e Lipjanit dhe sektorët e saj kanë nevojë më të madhe që të bëhet një menaxhim më i mirë i buxhetit, mirëpo nuk është bërë një gjë e tillë. Kemi projekte të cilat ende nuk kanë fillu, ndërsa janë paraqitur si të kryera.

Ramiz Qeriqi, dy qështje të cilat më ranë në sy mirëmbajtja dhe riparimi i veturave si dhe shpenzimet e derivateve të veturave. Kam pa raste me veturë zyrtare t'u udhëtu jasht orarit. Deshta me pyet se a i paisni me fletë udhëtim, a i këqyr dikush se mua më ka ndodh që t'i shohe nëpër të pame, dasma, me veturë të komunës. Është mirë që te mirëmbajtja dhe

servisimi i veturave të ketë një kontroll më të madhe pasi që edhe qeverisja e kaluar edhe e tashmja po i keqpërdorni.

Lulzim Rrustemi, te buxheti të hyrat vetanake te tabelat 21 rrogat dhe pagat 35 mijë euro pse nuk janë shpenzu, si dhe të hyrat vetanake të bartura 24 mijë euro pse janë mbetur këto pa u shpenzu.

Latif Ramadani, janë vlera reale ato që janë paraqitur në raport janë të planifikuara. Unë konsideroj shpenzim të mirë kur bëhet mbi 80% e shpenzimit të buxhetit, nëse e kemi 92.09% nuk e dijë se si të ju përgjigjem. Te granti qeveritar kanë mbetë suficit 113 mijë euro, janë tri projekte për shkak se nuk kemi pasur rishiqim të buxhetit, për shkak të kushteve klimatike nuk kanë mund me u shfrytëzu. Mirëmbajtja e veturave, anëtarësimet, dallimet në paga janë dikun faturat më të fryera se na vinë faturat me vonesë të muajit nëntor dhe dhjetor. I kemi specifiku për secilën kategori shpenzimet. Ekzekutimi i thesarit është bërë te pagat jubilarë 3+3. Te mirëmbajtja e komunës bëjnë pjesë kompania e "Pastrimit", mirëmbajtja e parçeve etj. Te adminiarata qysh është planifiku është realizu.

Lulzim Rrustemi, drejtori tha se nuk ka suficit.

Latif Ramadani, edhe nëse nuk e kam thënë është e shënuar.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi tha se shkojna në pauzë prej orës 12³⁵ deri në ora 13⁴⁵

VII

Propozim Vendim mbi dhënien e pelqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2017 dhe 2018 në vitin 2019

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadani, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, risi se kemi 9 projekte të reja janë të qëndrueshme. Te mjetet e mbetura e kam një vërejtje ku te zyra e kryetarit kanë mbetur 17 euro por është shfrytëzu mirë, ndërsa te drejtorati për bujqësi 43 mijë euro, drejtorati Kulturë, Rini dhe Sport 6490€. Në bujqësi kanë mbetur 60 mijë euro, te Kulturë, Rini dhe Sport 7395€. Ku bujqësia nga 60 mijë mbetet në 20 mijë dhe unë nuk pajtohem që këto mjete të barten te zyra e kryetarit, është dashtë që me shku mjetet te bujqësia e jo me iu marrë bujqësisë nga zyra e kryetarit. Ne si grup nuk e votojmë këtë bartje.

Egzon Bytyqi, unë isha ndalë te tabela nr. 15 ku dy prej tyre pritet të zhvillohen në fshatin tim Qylagë njëra rruga te varrezat. Po ashtu ka qenë një kërkesë e imja që në fshatin tim me u marrë parasysh edhe asfaltimi i rrugicave. Kisha dashtë të dijë nga këto 17 mijë euro a ka me u rregullu fusha e sportit.

Anila Reçica, falenderojmë drejtorin për bartjen e të hyrave vetanake nga vitin 2017-2018 në vitin 2019 ne si grup parlamentar i vendosim theks të veçant që gjatë dëgjimeve buxhetore janë marrë kërkesat e qytetarëve. Janë gjithsej 9 projekte të reja njëri ndër to parçet ekzistuese të cilat do të kenë ndriçim publik po ashtu zgjërimi i vendosjes së kamerave në qytetin e Lipjanit. Po ashtu janë edhe 7 projekte që i përfshin disa fshatra siqë janë: Gllgovci, Llugaxhia, Kojaska etj.

Albulena Kelmendi, ne si grup e mbështesim bartjen e të hyrave në projektet e reja e në veçanti asfaltimin e rrugës Janjevë-Teqe, po ashtu këta banorë po kërkojnë edhe mbrojtëset e rrugës për shkak të pozitës gjeografike që ka ky vend. Po ashtu presim një sqarim nga drejtori për bartjen e të hyrave nga bujqësia te zyra e kryetarit.

Nehat Tërpeza, unë deshta me u lidh me Lulin rreth bartjes së mjeteve nga bujqësia te zyra e kryetarit. Shtrohet pyetja kah do të merren mjetet për pagesën e shërbimeve të varrimit dhe ato mjete merren nga zyra e kryetarit. Ku kostoja e shërbimeve të varrimit është rritë nga 110 në 170€.

Latif Ramadani, mjetet që kanë mbetë nga drejtorati i bujqësisë janë bartë te zyra e kryetarit sepse nga zyra e kryetarit bëhen pagesat për shërbimet e varrimit. Rruga e varrezave në fshatin Qylagë ka qenë kërkesë e qytetarëve në dëgjimet buxhetore. Nërsa fusha e sportit në Qylagë në oborr të shkollës nuk mundemi për shkak të standardeve 20 me 40 të fushave e të cilën nuk mundemi ta ndërtojmë për shkak të oborrit të vogël të shkollës por në Qylagë e keni një fushë të ngjashme në pjesën e naltë sa për t'i kryer aktivitetet e tyre sportive.

Lulzim Rustemi, propozimi që t'i hiqen mjetet bujqësisë është gabim. Më mirë do të ishte që të hiqen nga Kultura, Rini dhe Sport. Pasi që bujqësia është më e rëndësishme.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se te drejtorati i bujqësisë nuk po zvogëlohen mjetet por vetëm po hiqen ato që kanë mbetë. Ndërsa te shkolla në Qylagë fusha të cilën e përmendët nuk e ka nxënë sipas standardeve të cilat po ndërtohen fushat por do të shohim një mundësi që të jetë një fushë më e vogël sa për kryerjen e aktiviteteve të nxënësve.

Latif Ramadani, bujqësia i ka të planifikuara në buxhet 130 mijë euro.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim e vendimit dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 25 vota për, 4 apstenime aprovoi këtë:

VENDIM

MBI DHËNJEN E PELQIMIT PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS SË LIPJANIT
TË VITIT 2017 DHE 2018 NË VITIN 2019

Neni 1.

Me këtë Vendim barten të hyrat vetanake në shumë prej 887,937.48€ që i përkasin viteve:

-Vitet 2018..... 747,369.04€

-Vitet 2017.....140,568.44€

Neni 2.

Mjetet nga Neni 1 i këtij Vendimi barten:

Tabela 1 Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2018 (21) në Mallra dhe Shërbime prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma në €
-Administrata (163)Programi -16303 shuma prej	465.58
-Zyra e kuvendit Komunal (169) Programi 16903 shuma prej	2,449.03
-Infrastruktura Publike (180) Programi -18163 shuma prej	2,182.78
-Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik (480) Programi (48003)	1,667.22
-Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	164.20
-Kulturë,Rini dhe Sport (850) Programi – 85003 shuma prej	13,275.81
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej	5,412.96
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-93060 shuma prej	17,422.11
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-94260 shuma prej	8,000.00
Totali për Bartje	51,039.69

Tabela 2. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2017 (22)në Mallra dhe Shërbime prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma në €
-Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	92.28
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej	0.16
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-93060 shuma prej	900.60
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-94260 shuma prej	5,581.33
Totali për Bartje:	6,574.37

Mjetet nga tabela 1 dhe nga tabla 2 barten në tabelën nr.3 Mallra dhe Shërbime:**Tabela nr.3.**

PROGRAMI	Shuma në €
-Administrata (163)Programi -16303 shuma prej	465.58
-Zyra e kuvendit Komunal (169) Programi 16903 shuma prej	2,449.03
-Infrastruktura Publike (180) Programi -18163 shuma prej	2,182.78
-Shërbimet e Zjarrefiksëve (180)) Programi -18215 shuma prej	5,000.00
-Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik (480) Programi (48003)	1,667.22
-Shëndetsi dhe Mirëqenie Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	256.48
-Kulturë,Rini dhe Sport (850) Programi – 85003 shuma prej	13,275.81
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej	5,413.12
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-93060 shuma prej	16,330.04
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-94260 shuma prej	10,034.00
Totali i bartur:	57,614.06

Totali i bartur.....57,614.06€

Tabela 4. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2018 (21) në Shpenzime Komunale prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma në €
-Infrastruktura Publike (180) Programi -18163 shuma prej	955.53
-Kulturë,Rini dhe Sport (850) Programi – 85003 shuma prej	38.64
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej	4,739.31
Totali për Bartje	5,733.48

Tabela 5. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2017 (22) në Shpenzime Komunale prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma në €
-Administrata (163)Programi -16303	3.00
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej	1,242.12
Totali për Bartje	1,245.12

Mjetet nga tabela 4 dhe 5 barten në tabelën 6. - Shpenzime Komunale**Tabela nr. 6**

PROGRAMI	Shuma në €
-Administrata (163)Programi -16303-shuma prej	997.17
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej	3,000.00
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-93060 shuma prej	2,981.43
Totali për Bartje	6,978.60

Totali i bartur.....6,978.60€

Tabela 7. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2018 (21) në Subvencione dhe Transfere prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma në €
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	17.00
-Bujqësia (470) Programi -47003 shuma prej	43,662.72
-Shërbimet sociale (755) Programi -75511 shuma prej	550.00
-Kulturë,Rini dhe Sport (850) Programi – 85003 shuma prej	6,490.00
Totali për Bartje	50,719.72

Tabela 8. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2017 (22) në Subvencione dhe Transfere prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma në €
-Bujqësia (470) Programi -47003 shuma prej	16,620.48
-Shërbimet sociale (755) Programi -75511 shuma prej	0.50
-Kulturë,Rini dhe Sport (850) Programi – 85003 shuma prej	905.00
Totali për Bartje	17,525.98

Mjetet nga tabela 7 dhe 8 barten në tabelen nr 9.- Subvencione dhe Transfere në këto programeve:

Tabela 9.

PROGRAMI	Shuma në €
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003	20,000.00
-Shërbimet sociale (755) Programi -75511	550.50
-Bujqësia (470) Programi -47003 shuma prej	20,000.00
-Kulturë,Rini dhe Sport (850) Programi – 85003 shuma prej	27,695.20
Totali për Bartje	68,245.70

Totali i bartur.....68,245.70€

Tabela 10. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2018 (21) në Paga dhe Meditje prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma në €
-Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	20,000.00
-Arsim dhe shkencë (920) Programi-92250 shuma prej	5,000.00
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-94260 shuma prej	10,000.00
Totali për Bartje	35,000.00

Tabela 11. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2017 (22) në Paga dhe Meditje prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma në €
-Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	6,376.79
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej	9,082.00
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-93060 shuma prej	8,720.00
Totali për Bartje	24,178.79

Mjetet nga tabela 10 dhe 11 barten në tabelen nr.12- Paga dhe Meditje prej këtyre Programeve:

Tabela 12

PROGRAMI	Shuma në €
-Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	26,376.79
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej	14,082.00
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-93060 shuma prej	8,720.00
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-94260 shuma prej	10,000.00
Totali për Bartje	59,178.79

Totali i bartur.....59,178.79€

Tabela 13. Mjetet e Mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2018(21) në Investime Kapitale prej këtyre Programeve:

-Zyra e kryetarit(160)Programi-(16003)-Pagesa për Vendime Gjyqësore-(89224)	12,765.48
-Infrastruktura Publike-Programi(18163-Kolektori i Ujërave të zeza Leletiq,Blinajë, Qylagë dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit Magurë- (42011)	30,415.76
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)- Riparimi i dëmeve në Infrastrukturën e Fsh.Gadime Eperme,Ulët, Vrellë, Sillovi, Smallushë,Qallapek (42012)	96,839.08
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163) - Bashkfinancimi me donator- (44511)	20,000.00

-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Jeta e Re-(45021)	1,702.94
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Asfaltimi i rrugëve në lagjet e fsh.Kraishtë-(45077)	6,276.68
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Asfaltimi i rrugëve në lagjet e fsh.Dobrajë (45080)	5,000.00
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Asf.i rrugës që lidh fshatrat Dobrajë e V-Magure”(45409)	1,300.00
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Asf.i rrugëve në fsh.Ribar i Madh dhe rr.e varrezave”(45415)	10,053.13
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Ndërtimi i trotuar. me ndriqim publik në Janjevë”(45433)	1,965.80
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Ndërtimi i trotuar. me ndriqim publik në fsh.Silovi(45438)	3.24
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Asfaltimi i rrugës Shqipëria-Haradin Bajrami”(45943)	100,000.00
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Ndertimi i kanalizimit ne fshatin Teqe (47364)	9,000.00
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Fasadimi i objekteve në qytet”(47368)	8,489.08
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Asfaltimi i rrugës Ribar i Madh- Torinë “(47372)	2,575.88
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163))-Ndërtimi i trotuar. me ndriqim publik në Banullë ruga e Livadhet e Thata”(47376)	4,712.47
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Mjetet e dedikuara për shpronësim-(47411)	33,524.03
-Planifikimi Urban dhe Mjedis (660)- Programi (66320)”Hartimi i projekteve detale-(47448)	698.62
-Planifikimi Urban dhe Mjedis (660)- Programi (66320)”Hartat zonale”(47449)	60,000.00
-Shëndetsi dhe Mirëqenja Sociale(730)-Programi (73200)”Renovimi i nyjeve sanitare dhe kanalizimit në QKMF”(42014)	9,508.00
-Shëndetsi dhe Mirëqenja Sociale (730)-Programi (73200)-Renovimi i strehomores se re-(47453)	11.00
-Sherbimet Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)-Rregullimi i fushes së futbollit në Magurë-(45414)	35,000.00
-Sherbimet Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)-Ndërtimi i fushave të vogla sportive në Lluga,Babush,Banullë (45465)	2,754.72
-Arsim dhe shkence(920) Programi-92250 - Ndertimi i qerdhes se femijeve ne Lipjan (45455)	70,000.00
-Arsim dhe shkence(920) Programi-93060 - Renovimi i nyjeve sanitare në shf.”Ismail Luma” dhe “Rexhep Akllapi”(42013)	928.00
-Arsim dhe shkence(920) Programi-93060 - Rrenimi i shkolles se vjeter dhe ndertimi i shkolles se re fillore në Silovi- (47380)	10,000.00
-Arsim dhe shkence(920) Programi-93060-Ndertimi i shkolles fillore ne fshatin Brus-(47381)	20,000.00
-Arsim dhe shkence(920) Programi-93060 - Rregullimi i infrastruktures në paralelen e ndarë Gllavic-Marevc- (47383)	1,343.00
-Arsim dhe shkence(920) Programi-93060 -Ndërtimi i shkollës në fshatin Rubovc faza e II-(47457)	50,009.24
Totali për Bartje	604,876.15

Tabela 14. Mjetet e Mbetura nga të hyrat vetanake(22) në Investime Kapitale prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma në €
-Administrata dhe Personeli(163)Programi(16303)-Sistemimi i rreshtit-(41964)	7,500.00
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shalë”(40184)	31.11
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin	16,656.96

Rubovc-(40198)	
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163),-Renov.lapidarit dëshmorit kombit Xhavit Kozhani (41935)	1,038.19
Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163),-Asfaltimi i rr.Dobratin-Silovi dhe rruga e Kuqe (41944)	36.00
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163),-Zgjerimi i rrjetit të kanaliz.fsh.Blinajë (41960)	240.31
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)- Riparimi i dëmeve në Infrastrukturën e fsh.Gadime Epërme,Ulët, Vrellë, Sillovi, Smallushë,Qallapek (42012)	9,042.00
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163),-Bashkfinancim me donatore- (44511)	165.08
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Asfaltimi i rrugës Blinajë-Leletiq-(45081)	9,660.07
Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Ndërtimi i rrjetit kanalizimit fekal fshati Akllap(45454)	7,157.46
Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)“Ndërtimi i rrjetit kanalizimit fekal fshati Varigovc(45466)	7,968.78
Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)- Mirëmbajta e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra- (45944)	7,247.97
-Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)-Përfund.punimeve sall.sporteve shf. Dobrajë e Madhe (41937)	4,706.65
-Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)- Ndërt.fushave sportive Gadime të Epërm dhe të Ulet(41942)	4,121.22
-Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)- Ndërtimi i bazanentit të shtatores Ismet Asllani dhe Arsim Zeqiri- (41961)	758.10
- Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)-Ndërtimi i stadionit të qytetit (43100)	384.35
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)-Rregullimi dhe renovimi i i banjove shf.”Zenel Hajdini” (41962)	71.30
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)“Rregullimi i infrastrukturës oborrit të shf.Bregu i Zi dhe shf.Mirenë (41963)	14,258.63
Totali për Bartje	91,044.18

Mjetet nga tabela 13 dhe 14. barten në tabelën 15. barten në këto projekte:

Tabela 15.

PROGRAMI	
-Administrata dhe Personeli(163)Programi(16303)-Sistemimi i rreshtit-(41964)	6,765.00
-Infrastruktura Publike-Programi(18163-Kolektori i Ujërave të zeza Leletiq,Blinajë, Qylagë dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit Magurë- (42011)	22,391.16
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)- Riparimi i dëmeve në Infrastrukturën e Fsh.Gadime Eperme,Ulët, Vrellë, Sillovi, Smallushë,Qallapek (42012)	99,968.13
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163) - Bashkfinancimi me donator- (44511)	20,000.00
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Mjetet e dedikuara për shpronësim-(47411)	33,524.03
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Ndërtimi i murit mbrojtës ne lumin e Gadimes së Epërme-(47451)	12,844.74
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Asfaltimi i rrugës në Torinë- Ribar i Vogë (47370)	14,916.59
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Rrenimi i objekteve te vjetra komunale dhe ndërtimi i rrethojës në oborrin e komunës-(42009)	2,045.00
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163) -Asfaltimi i rrugëve brenda qytetit të Lipjanit-(89228)	3,613.86
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Asfaltimi i rrugicave në lagjet e fashtit Gadime e Epërme- (45467)	3,630.60
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163)-Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Teqe- (47364)	25,000.00
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163) -Ndriqimi i parqeve ne qytetine Lipjanit - (Projekt i ri)	10,482.52
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163) -Asfaltimi i rrugicave në fshatin Teqe-(Projekt i ri)	28,500.00
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163) -Zgjerimi i sistemit të kamerave në Lipjan dhe instalimi i kamerave në fshatin Grackë- (Projekt i ri)	22,000.00

-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163) -Rregullimi i infrastrukturës para xhamisë në Gllogovc (Projekt i ri)	673.55
-Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163) -Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit në fshatin Llugaxhi “ (Projekt i ri)	48,500.00
Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163) Asfaltimi i rrugës së varrezave në fshatin Qylagë-(Projekt i ri)	22,500.00
Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163) -Ndërtimi i urave në fshatin Krojmir-(Projekt i ri)	12,000.00
Infrastruktura Publike(180)-Programi(18163) -Ndërtimi i urës në fshatin Kojskë mbi lumin “Sitnica” (Projekt i ri)	25,000.00
-Planifikimi Urban dhe Mjedis (660)- Programi (66320)-Hartimi i projekteve detale-(47448)	698.62
-Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale(730)-Programi (73200)-Renovimi i nyjeve sanitare dhe kanalizimit në QKMF- (42014)	8,887.90
-Sherbimet Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi(85003)-Rregullimi i fushes së futbollit në Magurë(45414)	35,000.00
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)- Ndërtimi i qerdhës së femijeve në Lipjan (45455)	111,683.55
-Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060)- Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Brus-(47381)	48,285.84
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-93060 - Renimi i shkollës së vjetër dhe ndërtimi i shkollës së re fillore në Sllovi- (47380)	10,000.00
-Arsim dhe shkencë(920) Programi-93060 -Ndërtimi i shkollës në fshatin Rubovc faza e II-(47457)	50,009.24
Arsim dhe Shkencë(920)Programi (93060) -Ndërtimi i platos dhe infrastrukturës në oborrin e shkollës në Fshatin Qylagë”-(Projekt i ri)	17,000.00
Totali për Bartje	695,920.33€

Totali i batur.....695,920.33€

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 7 dite pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Neni 5.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe MF-Prishtinë ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

VIII

Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2018

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Selatin Retkoceri, është mirë kur kemi rritje të të hyrave nga tatimi në pronë, unë pata me kundërshtu rrugën “Vëllëzërit Domanekuë por pasi që lidhet me tregun është e domosdoshme, për ndryshe unë isha i mendimit që këto mjete të shkojnë në arsim. Ndërsa platoja të Xhamia nuk po më duket shumë e nevojshme.

Lumturije Bytyqi-Hasani, në si grup e mështesim tejkalimin e të hyrave vetanake sidomos në Shëndetësi Mirëqenie Sociale dhe arsim pasi që nevojat po janë më të mëdha dhe si të tillë e përkrahim.

Lulzim Rustemi, e përshëndesim këtë rritje, është mirë që përmes rritjes po ju ndihmohet qytetarëve, rruga për Topliqan është e domosdoshme por sa i përket rregullimit të infrastrukturës para Xhamisë nuk po më duket aq e arsyeshme kur kemi nevoja më të mëdha nëpër shkolla.

Hyra-Bytyçi, ne si grup parlamentar i LDK-së dhe PD e mbështesim këtë propozim vendim pasi që është arritur progres dhe është duke u analizuar mirë dhe janë do projekte që kanë të bëjnë me shëndetësi, arsim. Ndërsa sa i përket rrugës Vllëzërit Domaniku dhe infrastrukturës para Xhamisë në fshatin Glllogovc kanë qenë kërkesa të qytetarëve gjatë dëgjimeve publike.

Latif Ramadani, vetëm një sqarim të rruga “Vëllëzërit Domaniku” është prioritet se aty janë varrezat, lidhet kah tregu e del në rrugën magjistrale. Pjesa tjetër ka qenë e rregullimit të infrastrukturës të Xhamisë në fshatin Glllogovc, një pjesë para Xhamisë aty ku është lumi, qytetarët kanë vendosur për ndërtimin e një shtepie për të pame për ata duhet rregullimi i infrastrukturës.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim e vendimit dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 vota për, aprovoi këtë:

VENDIM
PËR RITJEN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT NGA TEJKALIMI I TË HYRAVE
VETANAKE PËR VITIN 2018

Neni 1.

Me këtë Propozim Vendim të bëhet rritja e planifikimit të buxhetit të të hyrave vetanake në shumë prej **99,727.95€**. Kështu që vlera e të hyrave vetanake të planifikuara nga **1,936,601.00€** rritet në **2,036,328.95€**.

Neni 2.

Mjetet nga Neni 1 i këtij Vendimi planifikohen të destinohen si vijon:

Mallra e Shërbime:

Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej.....3,691.00€
Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 shuma prej.....4,710.50€

Totali Mallra e Shërbime8,401.50€

Investime Kapitale:

Infrastruktura Publike (180) kodi i programit 18163:

-Asfaltimi i rrugës “Vëllëzërit Domeneku” në Topliqan- (Projekt i ri).....72,000.00€
-Rregullimi i infrastrukturës para xhamisë në Glllogovc (Projekt i ri).....19,326.45€

Totali Infrastruktura Publike..... 91,326.45€

Totali i rritjes së të hyrave vetanake për vitin 2018 në krahasim me planifikimin e buxhetit është99,727.95€

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

IX

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Shfaqet Amerllahut, drejtor i DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, shuma e subvencioneve duhet të rritet, po më pëlqen edhe futja e arkave për bletarë. Por brengë e imja është këta fermer që po i marrin këto mjete a po i shfrytëzojnë në mënyrën e duhur apo po i çesin në treg. Gjithashtu kisha kërku me u formu një komision me i shiqu fermerët të cilët kanë marrë sera dhe motokultivator se si po i shfrytëzojnë.

Egzona Fazlija, kisha propozu që sera mos të jetë 50m² por të jetë një ari pasi që do të ishte mundësia më e mirë për punë po të ishte më e madhe.

Fadil Sopa, ne si grup parlamentar i LDK-së e konsiderojmë si prioritet strategjik ndarjen e subvencioneve për fermer pasi që ndikon në rritjen e punësimit dhe prodhimeve vendore në komunën e Lipjanit.

Albulena Kelmendi, ne e kemi diskutu edhe në KPF dhe është mirë që po ndahen këto mjete dhe duhet të përkrahen ata që po merren me bujqësi por sa i plotësojnë nevojat e ekonomive familjare këto sera e leje të plasohen produktet në treg. Do të ishte mirë që një shumë më e madhe të ndahet për sera, ndërsa më pak mjete për motokultivator se di se sa janë funksional këta, për ndryshe çdo përkrahje për bujqësi ne e mbështesim.

Nehat Tërpeza, deshta me pyet drejtorin se cila është kërkesa më e madhe e fermerëve për sera apo motokultivator në mënyrë që subvencionimi të bëhet në ato fusha ku ka nevojë më shumë.

Ukë Kryeziu, vendimi është për fermer dhe nuk mundesh me quajt ndihmë për fermer një serë me sipërfaqe 50m². Ka qenë kërkesë e jona që këto sera të jenë së paku 1 ari.

Nazmi Krasniqi, janë të mirë se ardhura subvencionet për bujqësi por kam një pyetje për drejtorin e bujqësisë se në vitin e kaluar që e keni ndarë subvencionet a ka pasur ndonjë kontrollë në teren për me i shiku përfituesit e serave pasi që unë e di një rast që e ka fitu serën dhe ka dashtë me kthy. Është mirë me caktu një komision me pasur një raport me pa se si po shfrytëzohen këto sera.

Ramiz Qeriqi, kam një kërkesë ku në kohën e fundit e kam vërejt se disa bujqë kanë marrë subvencione për shtalla dhe është dashtë për leje të shtallës me i pagu 1800€. Ndërsa në komuna tjera vetëm 250€ është mirë që këta bujqë të lirohën nga taksa nga kjo pagesë.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, dha sqarim se palët nuk paguajnë por sipas ligjeve duhet të bëhet shndërrimi i tokës bujqësore në ndërtimore.

Arben Salihu, kam një pyetje rreth këtyre tepricave por nuk e dijt kujt t'i drejtohem, drejtorit apo intepretuesve Rregulloreve të ligjeve kur bëhet prokurimi i kësaj çështje a kish pas mundësi të prokurohet me 60 mijë euro dhe ai që jep sasi më shumë të fitoj këtë projekt.

Afrim Miftari, edhe në vitin e kaluar kemi kërkuar që të rritet numri i serave në krahasim me numrin e motokultivatorëve. Përveç saj ne edhe në KPF kërkuam që të rritet sipërfaqja për sera prej 50 në 100m² mirëpo drejtori dha sqarimin se në bazë të kërkesave është sipërfaqe e mjaftueshme. Përndryshe ne e përkrahim si të tillë.

Majlinda Sylejmani, atëherë pasi që veç u përmend nga parafolësit që kërkesat për sera janë më të mëdha andaj ne si grup parlamentar i LDK-së propozojmë që 10 mijë euro

nga motokultivatorët të bartën për sera, 20 mijë të mbesin për motokultivatorë dhe 70 mijë për sera.

Lulzim Rrustemi, me qenë se kemi një propozim vendim me shuma të caktme për sera, arka dhe motokultivator. Unë kam një pyetje për drejtorin është mirë të bëhet një analizë për kërkesa shtesë nuk duhet shiquar vetëm baza ligjore. A duhet me u rritë serat? Pse duhet me u rrit serat? Nëse kemi nevojë duhet të shkojmë edhe më tepër sipërfaqe e jo të mbetet sipërfaqe e njëjtë. Duhet të bëhet një analizë dhe mos të bëhet rutinë po të shikohen kërkesat e fermerëve.

Shefqet Amerllahu, ne e kemi kriju një komision dhe do të dalim që t'i shikojmë në vend të ngjarjes të gjitha rastet. Nuk i japim nga 10 ari serë për shkak se kjo është e nivelit qendror. Sa i përket pyetjes që të ketë më shumë sera nëse jini ju në dakord mund ta bëjmë.

Nazmi Krasniqi, pata pyetje se a keni qenë në teren dhe nga përfituesit e serave a ka dikush që e ka marrë serën po nuk ka punu.

Shefqet Amerllahu, tash kur të fillon mbjellja e frutave ne do të dalim në teren dhe do të shiqojmë secilin përfitues. Po ashtu kemi dalë me inspekcion dhe policinë në teren ku e kemi konfisku një motokultivator të cilin një përfitues e ka postuar në rrjetet sociale për shitje.

Imri Ahmeti, ndër shqetësimet e mia dhe të asambleistëve është vërtetimi i faktit. Departamenti i bujqësisë duhet të marrë përgjegjësinë prej sot që rexhistri me emër dhe mbiemër kush ka marrë subvencion të gjitha kategoritë me u verifiku dhe me pru para asambleistëve. Të tregohet se nga gjithsej 120 sera sa sera janë funksionale, sa motokultivatorë janë shit e sa janë mbet dhe të nxjerret një raport nëse nuk është i mundshëm për seancën e parë, për seancën e dytë. Edhe unë e kam këtë shqetësim dhe qytetarët po na bëjnë presion për marrjen e serave dhe pres një raport prej juve për këtë çështje. Unë mendoj që edhe kësaj radhe të shkojmë si herën e kaluar, ndërsa vitet e ardhshme duhet me ndryshu mënyrën e dhënies së subvencioneve në bujqësi.

Nazmi Krasniqi, kemi një rast ku një përsone merret me bujqësi dhe shet në treg dhe nuk ju ka nda sera.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim e vendimit dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 vota për, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR FERMER

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare në shumë prej 100.000 €, për subvencionimin e fermerëve të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

1. Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të subvencionimit dhe furnizimit të fermerëve të Komunës së Lipjanit me serra në sipërfaqe prej 50 arka për bletar, dhe motokultivator si pas tabelës në vijim:

Numri i përfituesve	Çmimet
Serra në sipërfaqe prej 50 m ²	60,000 €
Arka për bletar	10,000 €
Motokultivator	30,000 €
Gjithsej	100,000 €

Neni 3

Procedurat e blerjes së serrave, arkave për bletar dhe motokultivatoreve do të zhvillohen nëpërmjet procedurës së prokurimit publik

Neni 4

Mënyra e përzgjedhjes së përfituesve do të bëhet nëpërmjet shpalljes publike për aplikim në pajtim me dispozitat e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016.

Neni 5

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2019.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi

X

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdinit , drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendim.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, gurëthyesit në Gadime e dijmë kush ju ka dhënë leje dhe kush i ka leju me punu dhe është vështirë me i ndalë ata gurëthyes. Në Gadime ka pasur edhe protesta të banorëve me i ndalë. Po ashtu aty është edhe një problem i depos së municionit ku gurëthyesit ju kanë ofru depos. Rreziku i madh është me shperthy ai tritol është mirë me u ndalë. Kërkojmë që të mbyllet depo edhe gurëthyesit. Zgjidhja më e mirë është që banorët e Gadimes dhe Babushit e posaqërisht lagja Tasholli dhe Lekaj të bëjnë një petition nëse dojnë me i mbyllë ata gurëthyes ose jo.

Ramiz Qeriqi, edhe unë jam kundër si parafolësi pasi që tash ka me u punu rruga për Gjilan dhe është interes i dikujt dhe ka me kanë dëm shumë i madh për banorët e Gadimes. Është dashtë me i pyet edhe banorët e Gadimës të cilëve ju shkaktohet pluhur, ju kanë dëmtuar edhe shtëpitë. Nëse dojna me ju ndihmu atyre operatorëve duhet me gjetë një lokacion të ri me një vend malor ku se pengon qytetarin. Dhe unë jam kundër këtyre gurëthyesve në Gadime, por po më intereson çështja rreth gurëthyesit në Shalë a ka leje dhe a i ka skadu afati pasi që këtu nuk është cek.

Ukë Kryeziu, para vetës kemi një propozim vendim shumë të rëndësishëm. Vendimi që do ta marrim sot do të ketë afekt edhe për vitet e ardhshme. Sa i përket gurëthyesve ka pasur paknaqësi të qytetarëve të cilat mund t'i quajmë edhe të drejta. Ku faji i është hedh herë nivelit qendror herë lokal. Është momenti që duhet të reflektojmë të gjithë pasi që është një vendim i matur dhe i guximshëm për interesin e banorëve të komunës së Lipjanit. Kam informacione se për me vepru në gurëthyes duhet të ketë dokumentacionin edhe të nivelit qendror dhe atij lokal dhe fatëkeqësisht operatorët e kanë vënë në lajthitje herë nivelin qendror herë ate lokal për qëllimet e veta. Është momenti që duhet të marrim një vendim dhe ky vendim duhet të keto parime: interesin qytetarë, që mos t'i dëmtohet prona private e tina

dhe mos t'i ulët cilësia e jetës. Gadimen e dijmë se sa herë kanë bërë petition e sa herë e kanë bllokuar at rrugë për shkak të gjendjes shumë të keqe nga ata gurëthyes pasi që janë afër shtëpive. Nuk është qëllimi i ynë t'i mbyllim gurëthyesit por të ju caktojmë kriteret aq sa na lejohet neve. Minimumi të jetë largësia 3 km na vendbanimi, mos të shfrytëzohet hapësira e mbuluar me pyje. Shikoni gjendjen në Gadime dhe Sllovi se si janë shkatërruar pyjet e qindra hektarë vetëm që të nxirret një guri për t'u shitur në Kosovë dhe jashtë vendit. T'i përcaktojmë kriteret që edhe ata të veprojnë por edhe qytetarët të mos dëmtohen.

Albulena Kelmendi, unë nuk e di se a janë pyet qytetarët për këta gurëthyes. Kisha sygjere që të formohet një komision që me u pyet këta qytetarë pasi që më së vështiri e kanë ata sepse jetojnë afër gurëthyesve. Me sa e di unë këta gurëthyes kanë punëtorë e të cilët janë të fshatrave aty dhe nuk kisha dashtë me i prekë interesat e tyre, pasi që kushtet ekonomike në Kosovë nuk janë të mira. Mendimi im është me i pyet ata banorë rreth gurëthyesve. Ne jemi kundër atyre gurëthyesve.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, që 5 vite Imri Ahmeti nuk ka prur asnjë gurorë të re dhe nuk ju kam vazhdu punën asnjë gurorës. Është problem i trashëgum dhe ndajë shqetësimin edhe unë me juve. Fakti i tretë që dola me dëshmu është se unë kam kërkesa me shkrim nga këta gurëthyes, pasi që kontratat e tyre shënojnë me mudësi vazhdimi. Dhe kërkesave të tyre obligim e ka Kuvendi pasi që Kuvendi është për dhënien e pronave. Një operatorë e ka pronën private por i ka edhe 5 hektarë të pronës publike, por janë edhe 3 operatorë tjerë që ju ka skadu kontrata. Dallimi i Gadimes me Shalën dhe Sllovinë është se në këto dyja prona është e agjensisë pyjore. Tash a është i gatshëm Kuvendi që këta gurëthyes mos me ju vazhdu punën ju do të vendosni. Unë nuk jam për me ja vazhdu asnjërit e as me prur operatorë të ri. Janë dy mënyra për pronat ajo përmes ankandit publik në zarfë të mbyllur dhe përmes të konkursit. Në kontratat e gurëthyesve e kanë pasur 87€ qiranë vjetore. Ne i kemi shti në sistem të gjitha lokalet dhe pronat e komunës tash kemi fillua edhe me gurëthyesit. Ndërsa sa i përket lejeve për gurëthyes ato i jep niveli qëndror.

Hyra Bytyçi, ne si grup parlamentar e përkrahim propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim për 16 vite përmes konkursit publik në Gadime të Ulët dhe Babush i Muhaxherëve dhe të vendoset taksa e shumë prej 20% që deri më tani nuk ka qenë e aplikueshme. Në vitin 2016 Isa Mustava ka pas marrë vendim që zonën e Gadimes të Shpella ta shpallë zonë të mbrojtur dhe qeveria aktuale e ka shfuqizuar këtë vendim dhe ne e kemi të pamundur që t'i ndalojmë pasi që ata janë të licencuar nga niveli qëndror.

Selatin Retkoceri, jeta e banorëve të Babushit, Gadimes ka qenë tmerrë për shkak të pluhurit, zhurmës nga kamionët. Ne kemi problem me vendos për këtë qështje pasi që në njërin anë po lypim investitorë në anën tjetër nëse ja mbyllim po i bjenë me i përzënë. Të kishim pas ndonjë petition nga qytetarët edhe për neve do të ishte më e lehtë. Unë kisha propozu që kjo pikë me u shty.

Lulzim Rrustemi, është një temë mjaft e ndijshme si për qytetarët ashtu edhe për gurëthyesit, temë e cila donë kujdes dhe maturi dhe mendoj që propozim vendimi nuk është i përgatitur mirë pasi që nuk ka saktësi të mirë pasi që unë kam menduar që do të jenë operatorë të ri dhe do të ipen 14 parcela. Unë mendoj që për këtë pikë ka peticione të qytetarëve, reagime të qytetarëve. Edhe unë pajtohem me Selatinin që kjo pikë të shtyhet dhe kisha propozu që të ketë një debat me qytetarët çfarë mendimi kanë ata dhe si mujn me arsyetu. Janë tri leje të cilat duhet me i marrë gurëthyesi dhe unë në emër të grupit parlamentar jam që kjo pikë duhet të shtyhet për një debat me qytetarët në mënyrë që mos ta dëmtojmë asnjërin palë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, aty janë tri kompani të njohura me emra dhe ne duhet të vendosim se a po duam me ua vazhdu punën apo po duam me i qu në shtëpi kjo don guxim politik. Sot merret vendimi ku sipas Ligjit kanë kohë 45 ditë me ofertu. Unë mendoj që ky duhet me shku në Kuvend dhe pas 45 dite me u kthi prap në Kuvend.

Albulena Kelmendi, ne po folim në të mirën e qytetarëve, se si merren lejet dhe qysh po shkon sistemi këtë punë po e dijmë të gjithë dhe nuk jemi për me ndalu zhvillimin

ekonomik të Lipjanit. Po dojna me u formu një komision që me i pa edhe mendimet e qytetarëve rreth këtyre gurëthyesve ky [sht] mendimi ynë si grup parlamentar ?

Daut Azemi, ideja për me i shty që me u pyet qytetarët nuk po më duket e arsyeshme, e dyta ne jemi të votuar nga qytetarët dhe ne duhet ta bartim barrën e qytetarëve.

Nazmi Krasniqi, gurëthyesi ekziston qysh në kohën e herëshme kur kam qenë unë fëmijë e që e mbajnë mend edhe gjeneratat më të vjetra e jo siç po thotë drejtori prej vitit 2009-2011 dhe kjo nuk është i sodit po është i mëhershëm. Unë jam që kjo pikë me u shty mos me ardh deri te mosmarrëveshjet në mes të kompanive dhe qytetarëve.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, ne po marrim një vendim me të cilën nuk do të mirret vendimi sot por siqë e tha edhe kryetari vetëm për me fillu procedurën kami kohë 2-3 muaj për me diskutu me qytetarët.

Ukë Kryeziu, më pëlqej fjala e kryetarit që tha duhet të kemi vendosmëri politike, guxim politik a dojmë të operojmë ata gurëthyes aty apo diqka tjetër. Na sot e kemi mundësinë për me ja dhënë vizën apo mos me ja dhënë. Unë kam të drejtë me folë në emër të qytetarëve të cilët ma kanë dhënë votën por gurëthyesit kanë me shku në secilën derë dhe me i pyet qytetarët dhe qytetari ka me i thënë pasi je ardh te shtëpia nuk më pengon. Ne e kemi mundësinë që të dalim në anën e interesave të qytetarëve e jo të interesave grupe. Dini me një qëndrim të përbashkët si parti pasi që kryetari tha unë nuk jam për me ia vazhdu, ndërsa grupi thotë jena për me ja vazhdu ose jo. Vota ime është kundër që të ju vazhdohet.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, sa i përket subjektit tonë politik qëndrimi i ynë dihet, ndërsa sa i përket guximit politik duhet ti më së pari me pasur guxim politik e me tregu se cilës parti e përfaqëson në Kuvend.

Ukë Kryeziu, guximi im shumë herë është dëshmu dhe unë i takoj grupit të PDK-së. Pasi që deri më tani nuk më është dhënë rasti të flas për këtë temë.

Arben Salihu, nëse marrim vendim me i ndalu kush është kompetent me e ekzekutu vendimin ne si komunë apo ministritë përkatëse.

Shkelzen Hajdini, unë nuk e di kush ka me vepru por puna e ekzekutivit është me pru te ju që të merrni një vendim. Na e kemi një vendim të datës 22 Janar 2016 të Isa Mustafës ku Gadimen e shpallë zonë të mbrojtur, ndërsa Kryeministri Ramush Haradinaj me 20 Dhjetor 2017 e shfuqizon atë vendim. Unë i përmenda do kontrata që janë të vitit 2009-2011 dhe ju kanë skadu.

Ilir Tasholli, po flas pasi që i takoj atij vendi ata gurëthyes së pari në vitet e 70-ta ka qenë gurthyesi shtetëror pastaj është blerë nga dikush privat nga një qytetarë i Gadimes në vlerë 400 mijë euro e më pastaj ka pasur edhe gurëthyes tjerë. Po ashtu është një depo për ruajtjen e fishek zjarreve të cilat konfiskohen po ashtu edhe prona për fermë të dhive e cila nuk ka punuar kurë. Unë mendoj që i takon Kuvendit me futë në sistem. Autostradat shumica prej tyre janë shtruar me gurë të Gadimes. Duhet të shikohet edhe interesi i qytetarëve por edhe zhvillimi ekonomik. Është i juaji kuvendar propozim vendimi për të cilin ju duhet të vendosni.

Argjend Tasholli, po thirrmi në emër të rritjes se pronës por nuk rritet vlera e pronës duke e shkatërruar pronën. Po ashtu po thirrmi edhe në punësim, si mund të ketë punësim kur ai pe shkatërron shtëpinë e vet. Nëse na pyesin neve banorëve se më çfarë gjendje jemi sidomos verës. Kryesues fshati i juaj Babushi nuk i keni lënë as nëpër fshat me kalu e leje sikur te ne që kanë bo gurëthyes. Këta gurëthyes nuk janë vetëm të kohës së PDK-së por ka që e keni pru edhe ju siqë është Niti.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, ne Babushi e kemi blloku rrugën dhe e bllokojna prap nëse na bëhet dëm bile ne edhe kemi përfitu duke na kompenzu për dëmin që naj kanë shkaktu.

Hyra Bytyçi, qëndrimi i grupit tonë është që kjo pikë të kaloj.

Ganimete Qeriqi, pajtohem me shumicën e diskutuesve po ashtu edhe me kryetarin. Qytetarët po dëmtohen jo vetëm të Gadimes e të Slllovisë por edhe na që po jetojna në qytet

për shkak të ndërtimeve që po bëhen çdo ditë. A ka mundësi ata punëtorë që punojnë në gurëthyes me ju gjetë punë dikun tjetër që do të jetë e mirë edhe e qytetarëve tjerë nëse do të lagoheshin ata gurëthyes dhe kogja duhet një guxim për të vendosur për këtë çështje.

Lumturije Bytyqi-Hasani, nuk është Kuvendi kompetent me i diskutu vendimet e qeverisë nëse ju e keni guximin mundeni me i mbyll ato biznese atje. Unë po shoh konflikt të ligjeve këtu pasi që në njërin anë qeveria ju ep lejen ndërsa ne jemi para një akti të kryer këtu. Unë mendoj që duhet me u bërë një koncenzus në Kuvend mos me i blloku as bizneseve por edhe qytetarëve ma ju spjegu se fjala është për të njëjtit operatorë. Është fjala për të njëjtat toka që deri tani i kanë pasur në shfrytëzim.

Ukë Kryeziu, është e vërtetë që në vitin 2009 kam qenë anëtarë i PDK-së por jo asambleist, po të isha do ta dini qëndrimin tim. Ku kam qëndrimin tim personal mbi parimet e qytetarisë.

Sefer Tasholli, sikur ne familja Tasholli që jemi të dëmtuar nga gurëthyesit në Gadime nuk është askush. Peticionet të cilat i kanë bërë qytetarët e Gadimes edhe unë si asambleist në atë kohë ka qenë me ndalu ndërtimin e fermës së dhive në Gadime. Ndërsa peticioni tjetër ka qenë kundër kompanis Ferix e cila ka shkatrua pronën duke kërkuar gurë por nuk ka prodhu. Ne i kemi për momentin tri kompani njëra ka fillu prej vitit 1965, tjetra është "Hashan" dhe "Niti".

Ramiz Qeriqi, kisha me qenë i kënaqur që në këtë temë të ishim të gjithë pa parti. Unë jam për me i mbrojtë të drejtat e qytetarëve aty pasi që po ka pluhur dhe po dëmtohet prona. A ka ndonjë vend tjetër dikun për me i bartë këta gurëthyes por jo në Gadime. Në Shalë ja keni pas dhënë që me marrë gurë ai për 10 vite pastaj me mbulu me dhe që e ka pasur sipas kontratës por nuk ka veprua ashtu. Për ata pyeta se a ju ka skadu kontrata ose jo?

Argjend Tasholli, nuk jemi kundër bizneseve por jemi që të mos dëmtohen qytetarët kur ndodh që shtrohen rrugët dhe dëmtohen nga kamionët. Kam një kërkesë nga inspektoriat që të mos e lejojnë të kalojnë kamionat mbi 5 ton. Kam një pyetje kto parcelat e reja a kanë me u dhanë për gurëthyes? Pse mos me u dhanë për diqka tjetër.

Lulzim Rrustemi, ne pa një debat publik me qytetarë nuk marrim pjesë në votim.

Imri Ahmeti, i kisha lut delegatët e LDK-së por edhe partive tjera mos u mundoni me nxjerr benefite nga kjo qështje. Nuk është mirë me pas tendenca duke ia lënë fajin njëra tjetrës e as LDK-ja me thanë kështu e kena gjetë. Ligjërisht atyre iu shënon me mundësi vazhdimi dhe ata kanë investuar aty me synimin që kanë me vazhdu punën. Ne mundemi me i gjosit çdo ditë por nuk kemi mekanizëm me shku me i hjek ato makineri. Unë iu kisha lut që sot të kalon kjo pikë pasi që i kemi 2 muaj me debatu rreth kësaj qështje, por ju prap vendosni vet e kur të kthehen rekomandimet nga ministria atëherë është vendimarrja.

Lulzim Rrustemi, ne jemi që me pas një debat me qytetarët me iu dhanë sqarim qytetarëve dhe kjo pikë me u shty.

Daut Azemi, një muaj merr kohë ligjshmëria deri sa të kthehet nga MAPL-ja dhe ne kemi kohë të mjaftueshme për debat me qytetarët.

Imri Ahmeti, prej ditës së sotme i keni një muaj për konfirmim nga ministria, plus 45 ditë për konkurrim dhe keni kohë të mjaftueshme për debat qoftë KPF-ja qoftë komisioni për prona. Unë mendoj që nuk është pak 1 muaj për të bërë debat me qytetarët.

Daut Azemi, tha se ktij propozimi i shtohet edhe parcela nr.562-6 me sipërfaqe 496m²

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim e vendimit dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 16 vota për, dhe 2 vota kundër, aprovoi këtë:

VENDIM
PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmëritë-pronat komunale që gjinden në Zonën kadastrale Gadime e Ulët dhe Babush i Muhaxherëve si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Kultura - klasa	Sipërfaqe m ²
1	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-9	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	22040
2	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-10	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	16395
3	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-11	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	36732
4	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-4	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	13370
5	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-12	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	30000
6	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-13	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	23500
7	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01977-4	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	5899
8	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01977-5	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	7063
9	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01984-2	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	16730
10	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01984-3	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	18335
11	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01984-5	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	14400
12	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01984-6	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	1600
13	Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409059-00559-5	Babush i Muhaxherëve	Bujqësore-kullosë kl.4-të	5875
14	Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409059-00562-4	Babush i Muhaxherëve	Bujqësore-kullosë kl.5-të	53120
15	Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409059-00562-6	Babush i Muhaxherëve	Bujqësore-kullosë kl.5-të	49296

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi pronat komunale ipen në shfrytëzim në afat prej 16 vitesh nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale është shfrytëzimi i shkëmbinjeve-seperim të gurëve apo të ngajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 4

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.463-67906 të datës 22.12.2017, në bazë të Rregullores QRK Nr.23/2013 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 16 vitesh.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Urbanizëm Planifikim, Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi

XII

Propozim Vendim për aprovimin e projekteve kapitale

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Ilir Tashollit, drejtor i DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit ,me të dhënat nga propozim vendim.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, po më vjen mirë për këto projekte, janë disa pika të mira, ajo çka më ka pëlqy është ndriçimi në fshatin Hallaq të Vogël, ku këtë pikë e kemi diskutu edhe në KPF. Është e mirë që do të bëhet ndriçimi për shkak të sigurisë, pasi që është afër aty edhe burgu, ne e përkrahim këtë propozim vendim.

Egzona Fazlija, është me përshëndet këtë propozim, por a kish pas mundësi me futë asfaltimin e rrugicave në fshatin Poturovc.

Nehat Tërpeza, sot kemi para vetës një propozim vendim për aprovimin e projekteve kapitale që ka të bëjë me një listë gjithpërfshirëse karshi nevojave dhe kërkesave të qytetarëve. Këto projekte të gjitha janë të rëndësishme siqë janë: shtigjet e bicikletave rreth shtratit të lumit “Sitnica”, rregullimi i lumit Janjevka, rregullimi i rrugës tranzit deri në Rufc, por ajo më e mirëpritura është asfaltimi i rrugës Ribar i Vogël-Ribar i Madh që është i mirëpritur nga banorët e të dy fshatrave e që është kërkesë e kahmotshme e që e ka historinë e sajë gjatë periudhës së luftës që me vetë kontribut është zhavoruar për të qenë në shërbim të UÇK-së dhe popullatës civile. Për këtë banorët e fshatit Ribar i Madh janë shumë mirënjohës qeverisjes aktuale të komunës së Lipjanit. Ne si grup parlamntar i mbështesim këto projekte.

Selatin Retkoceri, janë propozime me vend ajo që më së shumti po më pëlqen shtegu i bicikletave. Por kam edhe një propozim që për fshatin Llugaxhi, Rubovc dhe Kojskë të futen ujëmatësit pasi që kanë mbetë keq dhe kisha propozu që kjo të përfshihet.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, këto janë jasht buxhetit tonë por vetëm kur po aplikojmë se donatorët po kërkojnë që të kemi vendim prej Kuvendit për projektet të cilat aplikojmë. Neve këto po na duhet për me apliku. Njërin prej tyre veç e kemi përfunduar e kemi nënshkruar është fjala për shtegun për bicikleta.

Ramiz Qeriqi, është një projekt i qëllim shpresoj që do të kemi donatorë. Kërkesë e imja që shtigjet rreth lumit “Sitnica” të jenë me ndriçim.

Lulzim Rustemi, është një projekt i qëllim. Por nuk e dija a janë futë në ujësjellës fshatrat Ribari i Madh, Kraishtë dhe Topliqan është mirë me u përfshi. Po ashtu edhe

asfaltimi i rrugës Kojskë-Topliqan për shkak të kërkesës së qytetarëve dhe rëndësisë që ka kjo rrugë. Po ashtu edhe rregullimin e lumit “Sitnica”. Po ashtu në Rufc të Ri ka mbetur në gjysm ndriçimi është mirë të përfshihet.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, ujësjellësi për fshatrat Ribar i Madh, Kraishtë, Topliqan, Bregu i Zi është punë e kryer është marrëveshje me CDI-në dhe është në proces. Sa i përket çështjes së orëmatësve për fshatrat Kojskë. Rubovc, dhe Llugaxhi është zotu komuna dhe komuniteti para donatorit se këtë punë do ta kryejnë vet dhe kjo nuk ka ndodh tani kemi dy alternativa o me i vendos komuna orëmatësit ose vet banorët. Sa i përket ndriçimit do të përfshihet prej Hallaqit e deri në Magurë. Rrugen Topliqan-Kojskë e kemi parasysh kemi mendu me marrë prej Ministrisë pasi që është e kushtueshem pasi që është tereni i ulët. E kemi fut një urë për fshatin Kojskë mbi lumin “Sitnica” për shkak se aty është një urë e vogël dhe uji i ka përfshi livadhet. Projekti për rregullimin e lumit “Sitnica” është i gatshëm. Kemi nënshkruar marrëveshje me Ministrin e planifikimit hapsinor për kolektorin e ujërave të zeza në të dy anët e lumit “Sitnica” prej Rubovcit e deri në fund të teritorit të Rufcit të Vjetër. Nëse kemi ndonjë projekt me rëndësi jetike për qytetarët mundemi me përfshi.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim e vendimit dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 vota për, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E PROJEKTEVE KAPITALE

Neni 1

Me këtë Vendim , Kuvendi i Komunës së Lipjanit, **APROVON**, listën e projekteve kapitale për aplikim te donatorët dhe Ministrinë e ndryshme në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Lista e Projekteve kapitale, përfshin projektet si vijon:

1. Shtigjet e ecjes dhe shtigjet e bicikletave në Lipjan,
2. Vendosja e kioskave për shitje në Tregun e Gjelbër në Lipjan,
3. Rregullimi i shtratit të lumit Janjevka në Lipjan,
4. Asfaltimi i rrugës „Marie Shllaku“ nga Tranziti në Lipjan deri në Rufc të Ri,
5. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen e Konjuhut dhe mbrapa Stadionit në Qytetin e Lipjanit,
6. Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit „Sitnica“,
7. Ndërtimi i urave mbi shtratin lumit „Sitnica“ në fshatrat Rufc dhe Kojskë,
8. Asfaltimi i rrugës së „Shkupit“, „Iliridës“ dhe rrugës së „Lumit“ në Gadime të Ulët,
9. Asfaltimi i rrugës Ribar i Vogël-Ribar i Madh,
10. Ndriçimi publik në Hallaq të Vogël, Rufc të Ri, Torinë, Poturovc, Qylagë dhe Magurë,

Neni 3

Autorizohet, Kryetari i Komunës që duke u bazuar në dispozitat e këtij Vendimi, gjatë aplikimit për fonde të nxjerr Vendime të veçanta për aprovimin e secilit projekt nga lista e projekteve të cekura në nenin 2 të këtij Vendimi . Vendimet e veçanta nxirren në momentin e krijimit të kushteve për aplikim për projektin/projektet përkatëse .

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

Shtesë: Vendimi.

XII

Raport i punës zyrës së Kryetarit dhe drejtorateve komunal për vitin 2018

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Ahmetit kryetar i komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj kryesuesi hapi diskutimin?

Egzona Fazliu, Nisma Social Demokrate e ka shqyrtuar këtë raport të kryetarit për vitin 2018. Raporti vjetor i punës së kryetarit përmban shumë të pavërteta dhe ka mjaft mangësi. Po fillojmë nga pika e arsimit, në raportin e punës flitet për rritjen e numrit të klasëve por në raport nuk shohim se sa klasë janë shtuar apo sa janë rregulluar, ndërsa rritja e numrit të nxënësve automatikisht rritë numrin e puntorëve gjë e cila mundëson manipulimin e punësimeve partiake. Tek Inspektoriati deshta të njoftohem me gjendjen e gjobave mandatare se sa është numri i tyre. Tek Urbanizmi kemi shumë vërejtje, si: mungesa e rrethojave të objekteve që janë duke u ndërtuar gjë e cila rrezikon qytetarët. Afërsia e objekteve me njëra tjetrën dhe qështja e mbindërtimeve. Tek Shëndetësia kisha dashur që të intervenohet edhe në staf sepse nënat që vendosin ti kryejnë lindjet në Lipjan të kenë një lindje sa më të lehtë si dhe të investohet në barnatoren e QKMF-së që të jetë sa më funksionale. Te Prokurimi kam vërejtje në lidhje me dhënien e tenderëve që në shumicën e rasteve përfitojnë kompanitë nga Podujeva, si dhe kam një pyetje për rrugën “Hajredin Bajrami” pse nuk është përfunduar akoma ndriqimi.

Albulena Kelmendi, çdo raport që na sillet këtu në kuvend thuaj se është gjithmonë i njejtë, aty gjithçka është perfekte nga ana e pushtetit por në realitet asgjë nuk është ashtu siq paraqitet nga drejtoratet për punën e tyre. Po filloj me drejtoratin e administratës e cila është paraqitur se ka kryer punë një listë megalomane të cilat janë puna edhe në kohë të pauzës dhe orari i zgjatur në muajt korrik dhe gusht e asgjë më shumë nuk ka në këtë drejtorat. Tek Drejtorati për Arsim shihet që në raportin e këtij dikasteri askund nuk kemi të cekur se qfarë po ndodh me funksionalizimin e bibliotekave nëpër shkolla, gjithashtu askund nuk është cekur numri i të punësuarve apo numri i aplikantëve që kanë aplikuar për punë si dhe nuk shihet niveli i shkollimit të tyre. Po ashtu problemi i mësimdhënësve të gjuhës Gjermane ku nxënësit janë privuar me muaj të tërë nga kjo e drejtë siq janë në Rufc, Ribari i Madh etj. Sfidë tjetër ka qenë ambienti i akullt i klasëve, mbipopullimi i nxënësve etj. Sa i përket drejtorati të inspektoriatit është koncentruar më shumë në punë teknike por nuk kemi kërkuar ndonjë raport mbi inspektimin e kompanive private që operojnë në Lipjan, kur kemi punëtorë që punojnë deri në 13 orë në ditë pa pushime, pa kontrata pune e pa kushte për punë. Drejtorati për shëndetësi me krahasu me drejtorate tjera ka bërë një evaluim të sfidave, puna e bërë në këtë drejtorat nuk duhet ta knaqë këtë dikaster, urojmë që këtë vit të shkojnë gjërat për së mbari.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, disa çështje që u folën nga parafolsit janë të nivelit qendror e jo atij lokal dhe nuk duhet me i ngatërru këto çështje. Ligji i prokurimit dhe prokurimi janë online dhe Komuna e Lipjanit është ndër komunat më të mira sa i përket prokurimit. Është e mirë te prokurimi se aplikimi bëhet online dhe e fiton ai që është më i miri dhe është interesant te ne nëse e merrë “Ferizi” thojnë pse po i jep tenderin vetëm Ferizit, nëse e fiton “Dino” këta tjerët thojnë që Dino paska kalu në LDK. Nëse dikush mendon që është në pushtet e nuk do të hetohet tash ose pas 5 vite e ka gabim. Kur unë nuk flas në emër të qytetarit kush e merrë primatin të flas më me pak vota në emër të qytetarëve dhe vijmë zgjedhjet nacionale edhe ato lokale dhe qytetarët janë ata të cilët vendosin. Është e drejtë e juaja me dhënë vërejtje, sygjerime por ju edhe me akuzu pa fakte.

Nazmi Krasniqi, ka mujt me qenë një raport në vija të trasha. Unë jam mundu me i nxjerrë do raste te drejtorja e arsimit ku kemi formularët suksesi i nxënësve të gjysmvetorit të dytë nuk është. Po ashtu numri i të pa notuarve është afër 150 që është një shifër kogja e madhe. Po ashtu edhe mungesat e mëdha të nxënësve ku vetëm në shkolla fillore i bjet

46602 mungesa të nxënësve. Cikli i dytë mbi 80 mijë mungesa, ndërsa në shkollat e mesme mbi 100 mijë mungesa e që është një numër i madh i mungesave. Tjetra me sa e dijë unë ka pasur gara të nxënësve dhe fitore dhe nuk janë cekur në raport. Po ashtu për ekonominë e shkollës asnjë fjalë nuk është shenu. Në këtë raport nuk është bërë një analizë e mirë për me pas më lehtë në të ardhmen.

Lulzim Rrustemi, unë do t'i ngris 2-3 çështje është një raport jo i strukturuar mirë dhe me gabime gjuhësore. Te zyra e protokolit unë mendoj se është dashtë të përfshihen vizitat e kryetarit jasht vendit, marrëveshje mirëkuptimi, marrëveshje binjakëzimi, asocimi të cilat janë rezultatet e vizitave të kryetarit jasht vendit. Te arsimit menaxhimi është shumë i dobët, kemi shkelje të procedurave ligjore në punësim mbingarkesa nëpër klasa ndikon në cilësi. Është me dalë me rekomandime çka për vitin e ardhshëm në arsim. Për drejtorin e zhvillimit ekonomik kisha dashtë sqarim për zonat industriale në Babush deri ku ka mëbri. A ka punësime të reja? Edhe zona në Kërçevë është dashtë në raport me përshtu edhe rruga katër korsi deri te udhëkryqi për Janjevë. Te urbanizmi kemi një buxhet që nuk është shfrytëzuar mirë. Te arsimit është një vit që lenë për të dëshiruar. Ne si opozitë nuk jemi të kënaqur pasi që ka pasur mundësi të bëhet edhe më mirë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, një mesazh për ekzekutivin nga Kuvendi është mirë me u marrë seriozisht me këtë punë për drejtorat që po bëjnë gabime drejtshkrimore me u përmirësu pasi që janë dokumente publike.

Imri Ahmeti, për gjendjen në arsim jemi të njoftuar të gjithë ndërsa sa i përket mungesave të nxënësve në shkolla mund të mos jem i njohur, dakordohem me ty por është dakordu edhe populli me testin Pisa se çfarë gjendje kemi në arsim dhe për këtë është faji i gjithë shoqërisë. Kot investojna në shkolla nëse nuk kemi një arsim cilësor dhe këtu duhet të ketë bashkëpunim prind, mësimdhënës, nxënës dhe duhet të bëhemi bashkë pozitë e opozitë për çështjet e arsimit. Pajtohem me Lulin rreth zyrës së protokolit unë ju kam thënë drejtorëve të mi që të bijnë një raport sa më të shkurt dhe të kurtë. Se më herët i kam parë disa raporte me 195 faqe por e kam parë edhe raportin e Prishtinës i cili i ka vetëm 5 faqe dhe duhet me shku duke i shkurtuar dhe adresuar çështjet kryesore në raporte. Sa i përket gabimeve gjuhësore pajtohem me Lulin po kjo është punë e Sektorit të Kuvendit ku është lektori por si duket ai nuk i ka lekturuar fare, po ashtu të pranishëm e kemi këtu edhe shefin e sektorit dhe unë i pranoj vërejtjet.

Lumturije Bytyqi-Hasani, nuk po dëshiroj me mbrojt askënd edhe në raportin e mëhershëm është thënë se lektori por këtu gabimet janë të drejtorëve.

Albulena Kelmendi, ne edhe në KPF e kemi ngritë këtë çështje të lektorimit dhe të gabimeve që po bëhen nuk është puna vetëm e raportit por edhe në dokumente tjera zyrtare.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 17,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi